

STATUT I SHOQËRISË
“HAMIDA FARMA” SHPK

Ne Tirane, sot me date 18.11.2022, ne te nenshkruarit:

1- Z. Andis Neli, shtetas shqiptar, i biri i Nazmi-ut, i datelindjes 28.07.1979, lindur ne Burrel, Mat, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin nr. Personal: H90728064V, leshuar nga shteti shqiptar me date 12.05.2022, e vlefshme deri me date 11.05.2032.

2- Z.Heba Howard HAMIDA, shtetas Amerikan, i biri i Rrustem, i datelindjes 05.11.1958, lindur ne Algjeri, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten leshuar nga Shtetet e Bashkuara te Amerikes me nr.530980687, e vlefshme deri me date 10.05.2026

3- Z.Bokhari Syed Rukhsar Ulhassan, shtetas anglez, i biri i Fazal Hussain Shah i datelindjes 07.09.1964, lindur ne Gujrat, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikaur me Pasaporte me Nr. 534775132, leshuar nga shteti britanik, e vlefshme deri ne 16 Janar 2027

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria **“HAMIDA FARMA” SHPK**, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“HAMIDA FARMA” SHPK**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga **Z. Andis NELI, Z. Heba Howard HAMIDA dhe Z. Bokhari Syed Rukhsar Ulhassan** te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbëjne kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojne kuotat e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shqiperi- Dures, Xhafzotaj, Zk 2574, Nr. Pas 154/175 Kodi Unik 2574023104 Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te ortakeve te shoqerise.

Neni 4- Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Import - eksport suplemente, medikamente e lende te para, te licensuar nga organet e tjera kompetente ne rastet kur kerkohet.
- Tregtim me shumice e pakice te artikujve farmaceutik.
- Import -eksport paisjesh mjeksore, reagenteve dhe kiteve, servis paisjesh mjeksore dhe mirmbajtje.
- Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice, eksport, i prodhimit te industrise farmaceutike dhe kozmetike qe nga blerja e lendeve te para, materialeve, makinerive e pajiseve per keto sektore.

Neni 5- Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore pa afat.

KREU II KAPITALI

Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) lekë. Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga 3 (tre) ortakët e shoqerise **Andis Neli, Heba Howard HAMIDA dhe, Bokhari Syed Rukhsar Ulhassan,** , dhe perbehet nga:

- 1 (nje) PJESE me vlere 33 000 (tridhjetë e tre mije) Leke qe zoterohen nga **Z. Andis Neli,** qe perben 33 % te kapitalit themeltar te shoqerise
- 1 (nje) PJESE me vlere 33 000 (tridhjetë e tre mije) Leke qe zoterohen nga **Z. Heba Howard HAMIDA** qe perben 33 % te kapitalit themeltar te shoqerise
- 1 (nje) PJESE me vlere 34 000 (tridhjetë e kater mije) leke qe zoterohen nga **Z. Bokhari Syed Rukhsar Ulhassan,** qe perben 34 % te kapitalit themeltar te shoqerise;

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributet e ortakeve ne vijim mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët pergjigjen per humbjët e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7- Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te dy ortakeve te shoqerise në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.



Neni 8

Kuotat

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon pjesën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit sipas ligjit nr. 131/2015, " Per Qendren Kombëtare të Biznesit " Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave të të tretet kufizohet me miratim të asamblesë se ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

KREU II

ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve është organi i vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e ortakeve është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e ortaket, vendos për çështje si :

- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

ç) përcaktimin e shpërblimeve

- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga të dy ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10 – Administrimi

Administrator i shoqërisë do të jete nje prej ortakeve me te dhenat si me poshte vijon:

Z. Andis Neli, shtetas shqiptar, i biri i Nazmi-ut, i datelindjes 28.07.1979, lindur ne Burrel, Mat, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin nr. Personal: H90728064V, leshuar nga shteti shqiptar me date 12.05.2022, e vlefshme deri me date 11.05.2032.

i cili e perfaqeson shoqerine **kudo**. Administratori i shoqërisë e perfaqeson Shoqerine ne marrëdhënien me te tretet. Çdo akt i nenshkruar ne emer e per llogari te shoqërisë duhet te kete nenshkrimin e Administratori **Z. Andis NELI**, ose personat e autorizuar prej saj, ne te kundert nuk mund te sjelle efekte per te tretet. Administratori i shoqërisë emerohet dhe shkarkohet me Vendim te Asamblese se ortakeve me shumice votash. Emerimi i administratorit behet per nje afat 5 –vjecar.

Neni 11 - Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve te shoqërisë edhe ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike,

publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortaket që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Neni 14 **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e ortakëve të shoqërisë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e ortakëve të shoqërisë vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve të shoqërisë.

Në perfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tregëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakëve të shoqërisë në përpjestim me kontributet e tyre në kapitalin themeltar.

Neni 17

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakëve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin nr. 131/2015, “ Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tyre emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortaket e shoqërise.

Nëse ortaket e shoqërise nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.

Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje ligjin nr. 131/2015, “ Per Qendren Kombetare te Biznesit’.

Neni 21 Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22 Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të ortakëve të shoqërisë, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e tyre në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:

- kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta
- bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas ligjit nr. 131/2015, " Per Qendren Kombetare te Biznesit pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23 Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislatcionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te linden ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linden midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet me vullnetin e tij te lire nga ortaku themelues.

ORTAKET E SHOQËRISË "HAMIDA FARMA" SHPK

Z. Andis NELI

Andis Neli


Z. Heba Howard HAMIDA

Heba Howard Hamida

Z. Bokhari Syed Rukhsar Ulhassan

Bokhari Syed Rukhsar Ulhassan

Bokhari Syed Rukhsar Ulhassan




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



DATE 23/11/2022
NR REP 9515 *PC*

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 23.11.2022 vertetohet nënshkrimin e Ortakeve të shoqërisë "HAMIDA FARMA" shpk, përfaqësuar nga **Andis Neli**, atësia Nazmi, amësia Servete, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel, Mat dhe banues në Tiranë, me adresë Jordan Misja; Nd. ; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 28/07/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038270194 dhe nr. personal H90728064V, **Bokhari Syed Rukhsar Ulhassan**, shtetas anglez, lindur në Gujrat dhe blindur më 07/09/1964, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 534775132 dhe nr. personal 534775132, **Heba Howard Hamida**, shtetas Amerikan, lindur në Algjeri, lindur më 05/11/1958, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 530980687 dhe nr. personal 530980687, të cilët deklaruan se **Statuti** është nënshkruar prej tyre jashtë kësaj zyre noteriale dhe unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetohet nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MAJLINDA DEMOLLARI

NOTERE
Majlinda E. Demollari
MPP: 7416060404
Tel: 0682061560

